



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Sh.II.nr.1549/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditori Ministra e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve, me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.P. Voci, me seli në Shirokë, Komuna e Suharekës, me pronar L.V. nga Suhareka, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë- Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.86/20 të datës 16.03.2022, me datë 29.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit N.T.P. Voci me seli në Suharekë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë- Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.86/20 të datës 16.03.2022, APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.P. Voci i ushtruar kundër Urdhërit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.4203/18 të datës 05.12.2018 dhe ANULOHET urdhëri përmbarimor P.nr.4203/18 të datës 05.12.2018 i përmbaruesit Privat Isa Gacaferi nga Prishtina.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë- Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PP.nr.86/20 të datës 16.03.2022, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.P. Voci, kundër urdhrit përmbarimor P.nr.4203/18, të datës 05.12.2018, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, në pikën II të dispozitivit ka mbete në fuqi urdhrit përmbarimor P.nr.4203/18, të datës 05.12.2018, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi dhe në pikën III të dispozitivit shpenzimet e procedurës përmbarimore bien mbi debitorit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori N.T.P. Voci, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë- Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.86/20 të datës 16.03.2022, me propozim që të aprovet si e bazuar ankesa e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrin për Përmbarrim P.nr.4203/18, të datës 05.12.2018 si dhe të anulohet aktvendimi PP.nr.86/20 të datës 16.03.2022 i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë- Departamenti i Përgjithshëm dhe të kthehet lënda në rivendosje.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitori është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministra e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve, me datën 27.12.2018 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarrimit, kundër debitorit N.T.P. Voci, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 2,640.00 €.

Përmbarruesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.4203/18, të datës 05.12.2018, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturave Nr.B-115/2017 të datës 20.08.2017 dhe Nr. B-115/2016 të datës 20.08.2016, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 2,640.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarrimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarrimi në pjesën e pasurisë së

debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë- Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PP.nr.86/20 të datës 16.03.2022, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.P. Voci, kundër urdhrit përmbartimor P.nr.4203/18, të datës 05.12.2018, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, në pikën II të dispozitivit ka mbete në fuqi urdhrit përmbartimor P.nr.4203/18, të datës 05.12.2018, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi dhe në pikën III të dispozitivit shpenzimet e procedurës përmbartimore bien mbi debitorit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se nga vlerësimi i shkresave të lëndës konkretisht nga fatura me nr.B-115/2017 të datës 20.08.2017 dhe fatura B-115/2016 të datës 20.08.2016, këtu debitori është obliguar përmes urdhërit përmbartimor që t'ia paguaj kreditorit shumën prej 2.640.00euro. Ka shtuar se sipas vlersimit të kësaj gjykate baza e obligimit, faturat e lartëcekura si në propozim për përmbartim rrjedhin nga kontrata me nr.232 me dt.15.05.2006, me çka të njejta pra janë të parapara sipas nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, në të cilat hynë faturat si dokumente të besushëme.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale kujdeset sipas detyrës zyrtare, por vërtetimit i gjendjës faktike është bërë gabim ashtu sipas nenit 183 të LPK-së, por edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë, sepse dokumenti përmbartues-fatura nuk është e pranuar nga debitori, dhe se asnjëher nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, andaj nuk mund të konsiderohet si dokument përmbartues

ashtu sipas nenit 29 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, me të cilën është paraparë se “ *përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me faturën e cila nuk paraqetë dokument të besueshëm, dhe se e njëjta nuk i përmbanë tiparet e përmbartushmërisë , dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së. Ngase faturat rezultojn se nuk janë të nënshkruara dhe as të vulosura nga ana e debitorit me të cilën do të përmbanë bazë juridike për caktimin e përmbartimit, po ashtu propozimi për lejimin e përmbartimit është paraqitur vetëm në bazë të faturave në fjalë me të cilën edhe urdhëri për përmbartim është lëshuar në bazë të këtyre faturave, e jo edhe në bazë të kontratës me nr.232 e datës 15.05.2006, andaj, në procedurën përmbartimore gjykata vepron vetëm sipas dokumentit përmbartues të cilat janë të parpara me nenin 22 dhe 29 të LPP-së.

Kështu gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrtton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndë vlerëson se urdhëri për lejimin e përmbartimit është lëshuar në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave të pa pranuar nga ana e debitorit dhe si të tilla janë të pa përshtatshëm për përmbartim. Andaj, kjo gjykatë nuk e pranon si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për lënien në fuqi të urdhrit përmbartimor me të cilin është lejuar përmbartimi sipas propozimit të kreditorit i cili sipas kësaj gjykate nuk i plotëson kushtet ligjore për tu përmbartuar.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendim, mirëpo kreditori mund të inicoj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e

kërkesës së tij varësisht sipas suksesit në at procedurë. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjenë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe urdhri për lejimin e përmbarimit nga ana e Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi nga Prishtina të anulohet.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**  
K.Dh.Sh.II.nr.1549/23 dt. 29.05.2024

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri